



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTERISE VLORE
Notere Entiola Lamaj



Rep Nr.1895

Vlore, me 26/10/2019

VERTETIM NENSHKRIMI
NE STATUTIN E "ALB LIGATINA" SH.P.K

Ne Vlore, sot ne ditën e njetete e gjashte te muajit tetor te vitit dymije e nentembedhete ne Zyren Noteriale, perpara meje notere Entiola Lamaj, Noter Publike me seli ne lagjen "Hajro Cakerri", Rruga "S.Delvina" Vlore, u paraqit personalisht shtetasi me identitetin si me poshte:

- ✦ **SHERIF DURMISHAJ**, i biri i Veip-it, i datelindjes 28.08.1970, lindur ne Fier dhe banues ne Radhime, Vlore, madhore, pa pengese ligjore, me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje noteres, posedues i dokumentit me titull "Leternjoftim ID", me Nr.personal H00828031Q.
- ✦ **ARDIAN CERGA**, i biri i Qazim-it, i datelindjes 16.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane me adrese ne Njesin Bashkiake Nr.10, madhore, pa pengese ligjore, me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje noteres, posedues i dokumentit me titull "Leternjoftim ID", me Nr.personal F711160160.
- ✦ **SERGAN COBAJ**, i biri i Gazmir-it, i datelindjes 27.09.1990, lindur dhe banues ne Durres, madhore, pa pengese ligjore, me zotesi te plote per te vepruar, i panjohur prej meje noteres, posedues i dokumentit me titull "Leternjoftim ID", me Nr.personal J00927074W e vlefshme deri me 23.12.2020.

Te paraqiturit Sherif Durmishaj, Ardian Cerga, dhe Sergan Çobaj, nënshkruan dhe firmosen **STATUTIN** e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "ALB LIGATINA" SH.P.K., ne prezencen Time.

Une, Noterja, duke qene e bindur per identitetin e te paraqiturve dhe sa me siper eshte shprehje e lire e vullnetit te tyre, legalizoj dhe vertetoj nenshkrimin e tyre duke iu referuar Kodit Civil si dhe ligjit Nr.110/2018 "Per Noterine".



NOTERE
ENTIOLA F. LAMAJ

Notere Entiola Lamaj

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ALB LIGATINA ”SHPK

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia

Neni 1

Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot me date 26.10.2019, ne ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, me emrin “ALB LIGATINA” SHPK, formulojme Statutin e saj, si me poshte vijon ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Ortaket e shoqerise jane:

1.SHERIF DURMISHAJ, i biri i Veip-it, i datelindjes 28.08.1970, lindur ne Fier dhe banues ne Radhime, Vlore, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, pajisur me dokument identifikimi “Leternjoftim ID”, me Nr.personal H00828031Q.

2.ARDIAN CERGA, i biri i Qazim-it, i datelindjes 16.11.1957, lindur dhe banues ne Tirane me adrese ne Njesin Bashkiake Nr.10, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, pajisur me dokument identifikimi “Leternjoftim ID”, me Nr.personal F71116016O.

3.SERGAN COBAJ, i biri i Gazmir-it, i datelindjes 27.09.1990, lindur dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, pajisur me dokument identifikimi “Leternjoftim ID”, me Nr.personal J00927074W.


Neni 2

Objekti

Shoqeria “ALB LIGATINA” SHPK do te ushtroj veprimtarine si me poshte:

- 1.Peshkim dhe tregeti me pakice te peshkut dhe turizem,
- 2.Tregeti me pakice te materialeve te peshkimit
- 3.Agjensi Detare, Spedicion dhe parkim varkash, asistence te mjeteve te peshkimit.
- 4.Bar-Restorant
- 5.Import-eksport te peshkimit dhe materialeve te peshkimit.

Per te vetmin qellim te arritjes se objektit te lartepemendur, shoqeria mund te blej interesa, aksione, pjesmarrje te kapitalit, ne shoqeri te tjera, konsorciume ose kompani te cilat kane objekte te ngjashem apo analoge me te vetin dhe te kryej te gjitha veprimet komerciale, industriale, financiare duke perjashtuar ne menyre rigoroze ato me pasurite publike te tundshme dhe te patundshme qe jane konsideruar te dobishme dhe/ose te pershtatshme nga organi i vet administrativ.Gjithmon per te vetmin qellim te arritjes se objektit te lartepemendur, shoqeria mundet gjithashtu te jap garanci, garanci mbi kredite dhe depozitat, te lere peng te mira dhe vlera te tundshme, te vendos garanci hipotekore mbi te mirat e patundshme dhe te tundshme te regjistruara, dhe te vendos ne pergjithesi cdo garanci te mundshme reale dhe personale. Te njejtat garanci mund te vihen dhe ne interest e subjekteve te lidhura me te nga raporte ekonomike ose pjesmarrje me perjashtim te te tjereve.



Neni 3
Kohezigjatja

Kohezigjatja e shoqerise "ALB LIGATINA" SHPK do te jete mbi 10-vjet.

Neni 4
Selia

Selia e shoqerise "ALB LIGATINA" SHPK do te jete:

Rruga "Nikolla Xhuveli" Vlore, Zyra Çobaj CO 90 shpk .

Adrese e-mail. sherifdurmishaj@gmail.com, Nr.Cel 0684033369

Shoqeria mund te hape filial, dege apo perfaqesi ne te gjithë territorin shqipetar.

KREU II
Kapitali I Regjistruar
Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali i shoqerise eshte 1.000.000 (nje milion) leke, qe perbejne 100% te kapitalit.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre si me poshte

1. **SHERIF DURMISHAJ** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben **24.5 %** te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. **ARDIAN CERGA** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben **51 %** te kapitalit themeltar te shoqerise.
3. **SERGAN COBAJ** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben **24.5 %** te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta)

NENI 6

Te Drejtat dhe Detyrat e Ortakeve

Ortakët gezojnë keto te drejta e detyra themelore:

- te derdhen kuoten e kapitalit baze sikunder eshte paracaktuar ne nenin 7
- te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise
- te terheqin fitimin e realizuar
- te terheqin aktivin rezulant nga bilanci i likuidimit ne rast te pushimit te aktivitetit te shoqerise.
- te ruajne sekretin e aktivitetit te shoqerise
- te impenjohen ne arritjen e objektivave te shoqerise

NENI 7

Viti Financiar

Viti financiar i shoqerise fillon ne 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht vitit i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet ne 31 Dhjetor.

Neni 8

Pagesa e kuotave

Administratoret mund ti kerkojne ortakeve pagimin e kontributeve ne par ate pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre.

Ne rast te mosshlyerjes se kontributeve, sipas percaktimit te administratorit, personi pergjegjes do te paguaj nje kamat vonese mbi Shumen e paguar me interes 4% ne vit.

Neni 9

Kalimi I kuotave

Kuotat e kapitalit te nje shoqërie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nenpermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqërise.
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimie;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermejt ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirtisht te transferueshme me rruge trashegimie.

NENI 10

Kalimi i kuotave me trashegimi ose si pasoje e falimentimit

(1) Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të

bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.

(3) Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit ne QKB.

Neni 11

Zmadhimi e zvogelimi I kapitalit themeltar

Asambleja e pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhoj kapitalin themeltar te shoqërise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e ortakeve te rinj ne shoqëri, miratohet nga asambleja e pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

Shoqëria mund te vendos zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqërise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marr me shumice te kualifikuar te votave.

KREU III

Asambleja e Pergjithshme

Neni 12

Te drejtat dhe detyrimet



Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
- b) Ndryshimet e statutit,
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f) Zmadhimi dhe zvogelimin e kapitalit
- g) Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- h) Perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- i) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- j) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese
- k) Ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji apo Statuti.

Neni 13

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- a) Asambleja e Pergjithshme thirret nga administratori te pakten dy here ne vit, per te miratuar perkatesisht bilancin vjetor te mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.
- b) Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nepermjet nje shkrese derguar cdo ortaku me poste te zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet te kryet te pakten shtate dite perpara dates se caktuar per mbledhje.

Neni 14

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme

- a) Mbledhja e Asamblese eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve, per te vendosur per ceshtje te zakonshme. Ne Kete rast vendimi i asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga shumica e votave te ortakeve pjesmarres, (e cilesuar ne kete statut si "shumice e thjeshte").
- b) Mbledhja e Asamblese per te vendosur per ceshtje te vecanta si: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqerise, eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 50% te kuotave. Ne kete rast vendimi i asamblese eshte i vlefshmen nese eshte votuar nga jo me pak se tre te katertat e votave te ortakeve pjesmarres, (e cilesuar ne kete statut si "shumice e kualifikuar").
- c) Mbledhja e Asamblese drejtohet nga administratori nese eshte e thirrur prej tij. Nese Asambleja e Pergjithshme eshte thirrur nga pakica atehere ajo kryesohet nga njeri nga ortaket e zgjedhur nga pjesemarrsit ne ate mbledhje.
- d) Administratori pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesemarrjes si edhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 15

Votat e pjesemarrseve

- a) Cdo kuote i jep ortakut te pranishem apo perfaqesuesit te tij te autorizuar te drejten e nje vote.
- b) Asnje ortak nuk voton ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kuotat, qe ai disponon.

Neni 16

Emerimi i administratorit

- a) Administrimi si dhe perfaqesimi i Shoqerise i besohet nje Administratori te vetem qe mund edhe te mos jete ortak.
- b) Detyra e Administratorit te vetem i ngarkohet Z.Sergan Cobaj te cilit i jepet e drejta e firmes dhe e perfaqesimit te shoqerise, **per nje afat 5-vjecar me te drejte riperteritjeje.**
- c) Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoj ne cdo kohe Administratorin nga detyra, me shumice te zakonshme votash, me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Neni 17

Kompetencat e administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet:

- a) Te kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- b) Te perfaqesoj shoqerine.
- c) Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise
- d) Te bej te mundur pergatitjen nga specialist i ngarkuar dhe te nenshkruaj bilancin vjetor parashikues per vitin e ardhshem per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme, sipas afateve te caktuar ne legjislacionin perkates.
- e) Te bej te mundur pergatitjen nga specialist i ngarkuar dhe te nenshkruaj bilancin vjetor te mbyllur, per tu miratuar nga Asambleja e Pergjithshme Brenda dates 20 mars te vitit te ardhshem dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, liparaqet keto dokumente perpara asamblese se Pergjithshme per miratim
- f) Te krijoj nje sistem monitorimi e njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- g) Te kryejne regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te shoqerise
- h) Te raportoj perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare
- i) Te kryej detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe statut.

Neni 18

Mbledhjet e administratorit

Administratori kujdeset qe ne ne libra te posacem te mbaj procesverbalet e te gjitha takimeve te kryera nga ai, si dhe te gjitha mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

KREU IV

Shperndarja e fitimit vjetor te shoqerise

Neni 19

Shperndarja e fitimit vjetor

- a) Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga Asambleja e Pergjithshme.
- b) Asambleja e Pergjithshme ka kompetence tu shperndaj ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

c) Po kështu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

KREU V
Prishja dhe Njoftimet
Neni 20
Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

Prishja dhe likuidimi i shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

1. Kur mbaron kohezzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
2. Me vendim të asamblese së ortakëve;
3. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për mbi dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
5. Me vendim të Gjykatës.

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "Shoqëri në likuidim të siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 21
Ftesat për kreditorët

Likuiduesit duhet të ftojë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit si dhe në faqen e internetit të QKB. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

Neni 22
Perfundimi i Likuidimit

a) Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton QKB për perfundimin e likuidimit dhe kërkon regjistrimin e shoqërisë.

b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas regjistrimit të shoqërisë, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.



Neni 23

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitar ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregetarët dhe shoqerite tregetare".

Neni 24

Dispozitat e fundit

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregetarët dhe shoqerite tregetare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

ORTAKET E SHOQERISE "ALB LIGATINA" " SHPK

SHERIF DURMISHAJ


(emer, mbiemer, nenshkrim)

ARDIAN CERGA


(emer, mbiemer, nenshkrim)

SERGAN ÇOBAJ


(emer, mbiemer, nenshkrim)